



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 441/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazic dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zela Krasniqit në Prishtinë, paraqitur kundër anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Zela Krasniqit nga Prishtina.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, nga Zela Krasniqi në Prishtinë, në të cilën ka pretenduar se, në fillim ka shkuar në fakultetin Teknikë për të votuar së bashku me nënën e saj. Më tutje ka theksuar, pasi që e përfunduan votimin ajo shkoi në shkollën Hasan Prishtina në Prishtinë për të votuar dhe pasi ia kontrolluan duart u vërejtën disa shenja që janë kapur duke i ndihmuar nënës së saj andaj nuk iu lejua. Për më tepër ka theksuar se vetëm i ka ndihmuar nënës së saj dhe nuk ka votuar vetë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e ankueses në ankesën e saj se fillimisht ka shkuar në qendrën e votimit në fakultetin Teknikë në Prishtinë, për t'i ndihmuar nënës së saj gjatë votimit dhe me këtë rast i janë kapur disa shenja në duar, ku pasi që është kthyer në vendvotimin e saj në shollën fillore Hasan Prishtina në Prishtinë, nuk iu lejua të votoj. PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 441/2013 më datën 06.11.2013.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*